

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER DRITAN J. GJANA



V2024053160264991059

DATE 02/07/2024  
NR REP 3685



Sot, më datë 02/07/2024, para meje Noter DRITAN J. GJANA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tiranë, Rr. NIKOLLA JORGA, NR.1, NR.2, u paraqit personalisht:

**NËN SHKRUES:**

**Marco Gualandri**, i lindur në Romë (RM) më 19/03/1966, banues në Romë në rrugën Via dei Barbisio nr. 29, C.F. GLNMRC66C19H501G, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me pasaportën e tij N.YB3126271

Shtetasi italain i mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje Noterit, **"STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "VIVENDA ALBANIA" SH.P.K."**, bashkëlidhur.

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personave të sipërejtuar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërmë "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhc Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.



NOTER  
DRITAN J. GJANA

STATUTI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"VIVENDA ALBANIA" sh.p.k.

sh.p.k

KREU I

KRIJIMI, FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA DHE KOHEZGJATJA E SHOQËRISË.

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "VIVENDA ALBANIA" sh.p.k., me seli të sëj ligjore në Tiranë, te Kulla Condor Center H, Kati i 5-të, Ap. 14, Rruga e Xavajes, është krijuar në përputhje me kontratën e bashkëngjitur këtij statuti të përpiluar dhe të nënshkruar nga:

1) Shoqeria italiane "Vivenda S.p.A." me seli në Romë, në rrugën F. Antolisei, 25 - 00173 Romë Kod Fiskal/Nr. identifikimi Tvsh 07864721001, e regjistruar në Dhomën e Tregtisë së Romës në nr. 07864721001, përfaqësuar nga z. Marco Gualandri, i lindur në Romë (RM) më 19/03/1966, banues në Romë në rrugën Via dei Barbisio nr. 29, C.F. GLNMRC66C19H501G, i identifikuar me pasaportën e tij N.YB3126271, në cilësi të Këshilltarit të deleguar të shoqërisë dhe përfaqësues ligjor i shoqërisë, (në vijim "Vivenda"), e cila ka rënë dakord për themelimin e shoqërisë "Vivenda Albania" sh.p.k.,  
Themeloj në përputhje me dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare" nr. 9901, datë 14.04.2008, dhe ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, "Per Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", si më poshtë:

Neni 1

Themelimi

Shoqëria fiton personalitet juridik nga dita e regjistrimit të saj.

Emri i shoqërisë është "Vivenda Albania" sh.p.k.

Shoqëria është një person juridik me përgjegjësi të kufizuar sipas të drejtës shqiptare (në vijim të referuar si "Shoqëria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria "Vivenda Albania" sh.p.k. është një shoqëri tregtare e themeluar nga i vetmi ortak i shoqërisë, i cili është përgjegjës për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon drejtpërdrejt humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pakryer të kontributave të nënshkruara. Kontributet e ortakut të vetëm përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Neni 3

Selia ligjore

Shoqëria do të ketë selinë e saj në Tiranë, te Kulla Condor Center H, Kati i 5-te, Ap. 14, Rruga e Kavaje.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësimi, filiale, brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria "Vivenda Albania" sh.p.k. do të ketë si objekt të veprimtarisë këto aktivitete:

Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimin, dhe menaxhimin e qendrueshëm ose të përkohshëm në llogari të vete ose për llogari të paleve të treta me kontrata ose marrëveshje me autoritetet publike italiane, shiptare dhe të huaja ne pergjithesi, dhe me persona private ne pergjithesi, të aktiviteteve të mëposhtme:

(i) aktivitete hotelerie, restoranterie dhe turistike, qoftë përmes marrjes së menaxhimit të shërbimeve të restoranteve kolektive (veçanërisht kantinave, restoranteve, bareve dhe klubeve, restoranteve të shpejta dhe tavolinave të ngrohta, në favor të kompanive, autoritetet publike dhe private, komuniteteve civile dhe fetare, shkollave të gjitha niveleve, institucioneve universitare dhe shkollave të specializimit, spitaleve, shtëpive të kujdesit dhe shtëpive të të moshuarve) qoftë nëpërmjet menaxhimit të drejtpërdrejtë dhe/ose për llogari të paleve të treta, të strukturave rezidenciale sociale dhe shëndetësore, pensionateve, kolegjeve, hoteleve, shtëpive hotelierike, gendrave të kujdesit për të moshuarit, fshatra turistikë kampe, restorante, bare dhe klube, restorane të shpejta, taverna si dhe shërbime banketimi, si në ambiente publike, ashtu edhe në klube, shoqata ose kompani private, dhe kryerja e çdo aktiviteti të ngjashëm si furnizimi dhe prodhimi i vakteve të transportuara, duke perfshire edhe transportin e tyre nga vetë shoqëria apo për llogari të paleve të treta, si edhe furnizimi i produkteve ushqimore, qoftë në Itali, në të huaj dhe në zona të lira doganore; aktivitete furnizimi të shërbimeve zëvendësuese të kantinave përmes emetimit të "bonove për vakte". Në këto fushra, shoqëria mund të projektojë dhe të realizojë iniciativa kërkimore shkencore dhe teknologjike, analiza dhe studime për fizibilitetin, menaxhimin dhe ekonominë; furnizim me vakte dhe/ose shërbim ushqimor në qendrat e pritjes dhe menazhimit të përcaktuara në Protokollin ndërmjet qeverisë së Republikës së Italisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për forcimin e bashkëpunimit në fushën e migracionit, të nënshkruar në Romë më 6 nëntor 2023 dha ratifikuar me Ligjin nr. 14/2023

datës 21 shkurt 2024, në strukturat e Shëngjinit dhe Gjadërit;

(ii) aktivitete furnizimi me shërbime pastrimi, dezinfektimi, deratizimi, si dhe shërbime të ngarkesave dhe transporteve të të gjitha llojeve dhe llojeve në emër të vet dhe për llogari të palëve të treta;

(iii) aktivitete shitje me pakicë të mallrave ushqimore dhe jo ushqimore.

(iv) Aktiviteti i: grumbullimit, seleksionimit, transportit, asgjësimit dhe djegies termokatakritike të mbetjeve të ngurta urbane, mbetjeve urbane të rrezikshme, mbetjeve të veçanta të krasueshme me mbetjet urbane; grumbullimi, transporti, djegies termokatakritike ose përpunimi i frakcioneve të ndara të mbetjeve të ngurta urbane të grumbulluara në menyre të diferencuar, mbetjeve të vëllimshme; pastrimi i mbetjeve urbane të jashtme dhe shërbimeve plotësuese të lidhura; magazinimi i përkohshëm, grumbullimi, seleksionimi, transporti dhe djegies termokatakritike e mbetjeve të veçanta dhe mbetjeve të rrezikshme dhe dëmtuese edhe të palëve të treta ose për llogari të palëve të treta; trajtimi kimik dhe/ose fizik dhe/ose biologjik i mbetjeve të veçanta dhe mbetjeve të rrezikshme dhe dëmtuese; magazinimi i përkohshëm i mbetjeve të ngurta urbane në transfer dhe i materialit që rrjedh nga grumbullimi i diferencuar i mbetjeve të ngurta urbane dhe mbetjeve urbane të rrezikshme për llogari të palëve të treta; përzgjedhja paraprake e mbetjeve të ngurta urbane; prodhimi dhe/ose djegja e karburanteve të nxjerra nga mbetjet; prodhimi i kompostit të nxjerrë nga mbetjet;

v) Aktivitetet e deponisë në emrin e vet ose për llogari të palëve të treta; transporti jo i kanalizuar i ujërave;

(vi) Aktivitetet në emër të vet, me kontratë ose gjithsesi për llogari të palëve të treta, të punës dhe prodhimit në fushën e punimeve ndërtimore, hidraulike, elektrike, lyerjes së sipërfaqeve, kopshtarisë dhe mirembajtjes së hapësirave të gjelbra publike, mirëmbajtjes, instalimit dhe drejtimit të impianteve teknologjike të ndryshme në prona civile dhe industriale të privatëve ose administratave publike, duke përfshire edhe kontrollin e gjendjes efektive të mirëmbajtjes; shpërndarja e produkteve kimike dhe pajisjeve dhe çdo tjeter mall që ka lidhje me aktivitetet e paraqitura në objektin shoqëror;

(vii) Aktivitetet e inventarizimit, vlerësimit, inventarizimit, mbrojtjes së pasurive kulturore dhe mjedisore, hetimit, kërkimeve-studimeve sociale dhe ekonomike për llogari të komunave dhe autoritatave publike, administrative, teknike dhe kulturore, si dhe ushtrimi i aktivitetit të arkëtimit të taksave dhe aktiviteteve plotësuese të tij kur lejohet me ligj;

(viii) Aktivitete të transportit të nxenësve, personave me aftësi të kufizuara, punonjësve etj. për llogari të administratave publike ose privateve; qiradhënie automjetesh me shofer, larje dhe qiradhënie e carcafeve të shoqësura, t.a. kamionët, etj.

për strukturat shëndetësore publike dhe private; shtëpitë e plegve përtë moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, me të gjitha shërbimet përkatëse, të nevojshme për një funksionim të plotë;

x) Aktiviteti i projektimit grafik, instalimit, menaxhimit dhe mirëmbajtjes së tabelave rrugore dhe impianteve të semaforëve dhe ndriçimit publik;

(xi) Aktiviteti i shërbimeve të mirëmbajtjes së rrugëve në përgjithësi, duke përfshirë edhe pastrimin e rrugëve dhe bordureve të tyre, shërbimet e mirëmbajtjes dhe menaxhimit të hapësirave të gjelbra rrugore, duke përfshirë mbjelljen, krasitjen dhe kositjen e bimëve dhe shkurreve në përgjithësi; vendosja dhe mirëmbajtja e barrierave metalike rrugore, bojërave, shenjave që kanë të bëjnë me sinjalistikën rrugore, hekurudhore, portuale, aeroportuale, toponimike dhe të lidhura me to, konstruksionin metalik, impiante elektrike dhe elektronike të sinjalizimit rrugor (duke përfshirë edhe mesazhet e ndryshueshme me menaxhim kompjuterik), hekurudhore, portuale dhe aeroportuale, impiante të semaforëve, sisteme kompjuterike të centralizuara të kontrollit dhe menaxhimit të trafikut rrugor urban dhe të autostradave; menaxhimi i parkingjeve dhe sinjalistikës së tyre të menaxhuar me kompjuter përllogari të klientëve publikë ose private; menaxhimi i shërbimeve në përgjithësi dhe të lidhura me aktivitetet portuale dhe aeroportuale si, me përdorimin edhe të pajisjeve dhe mjeteve të posaçme për asistencën e avionëve: shërbime që kanë të bëjnë me operacionet e ngarkimit, shkarkimit, transferimit, asistencës së avionëve, depozitimit dhe lëvizjes në përgjithësi edhe me ndihmën e mjeteve mekanike, të posaçme ose të ndryshme; ngarkimi dhe shkarkimi i mallrave në përgjithësi, fiksimi dhe lirimi i tyre në përgjithësi, vënia e shenjave, ruajtja, roja, kryerja e çdo shërbimi teknik të kërkuar, lyerje, pastrimi i detit, pastrimi i molove, i baseve të ujit dhe i zonave portuale në përgjithësi; mirëmbajtja e pjesëve të përbashkëta në hapësirën portuale dhe aeroportuale; peshimi, matja, numërimi, kontrolli i mallrave; ofrimi i shërbimeve me interes të përgjithshëm për përdoruesit e portit; ankorimi, çankorimi në përgjithësi; vendosja dhe heqja e shkallëve nga anijet pasagjerë; bartja e bagazheve; asistenca e pasagjerëve; aktivitetet paraprake, plotësuese dhe të ngjashme me ato të mësipërme të kryera si brenda zonave portuale ashtu edhe jashtë tyre;

(xii) Aktiviteti i menaxhimit të integruar të pronave të paluajtshme përllogari të administratave publike dhe private; mund të kryeje të gjitha aktivitetet e verifikimit të impianteve termike dhe integrimet dhe modifikimet pasardhëse; mund të kryejë shërbime ndihmëse; mund të kryejë projektimin, realizimin dhe menaxhimin e qendrave të thirrjeve telefonike (të quajtura "call center") edhe të integruar me shërbime të ndryshme; mund të kryejë shërbime ndihmëse; mund të kryejë shërbime ndihmëse;

konsumeve në përgjithësi (telefonike, energjetike, të gazit dhe ujit); gjithashtu mund të kryejë aktivitetet e arkivimit (fizik dhe dixhital) të çdo lloj dokumenti dhe të dhënat që i përkasin administratave publike dhe private, edhe në vende të largëta me shërbimet përkatëse të ruajtjes, dorëzimit, transportit, magazinimit si dhe shërbimet përkatëse të "rimëkëmbjes nga katastrofa".

(xiii) Aktiviteti i asistencës teknike dhe administrative të shoqërive pjesëmarrëse si dhe kujdesi edhe nепërmjet ~~me~~shërbjes informatike ose telematike të strukturës organizative dhe financiare të tyre;

(xiv) Aktiviteti i ofrimit të shërbimeve të menaxhimit të integruar të të gjitha ose një pjese të shërbimeve të perfshira në objektin shoqëror, në emër të vet dhe për llogari të palëve të treta (e quajtur "global service"), shërbime të integruara dhe/ose multishërbime dhe/ose për kryerjen e aktiviteteve të menaxhimit të objekteve (facility management) në favor të administratave publike dhe private.

(xv) Aktiviteti i promovimit të punësimit, përfshirë edhe me kohë të pjesëshme, të studentëve universitarë, të personave me aftësi të kufizuara, migrantëve, nënave të reja, të burgosurve, personave me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore, për të realizuar objektivat e vetë-menaxhimit të shërbimeve universitare të parashikuara nga legjislacioni kombëtar dhe rajonal në fuqi për të drejtën për studime universitare, si dhe forma të solidaritetit social dhe të integrimit dhe punësimit, duke përfshirë edhe punësimin e punëtorëve të huaj nga vendet në zhvillim.

Shoqëria mund të kryejë të gjitha operacionet tregtare, industriale dhe financiare që këshilli i administrimit i konsideron të nevojshme ose të dobishme për arritjen e objektit shoqëror. Për qëllime të realizimit të objektit shoqëror, shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme dhe çdo aktivitet tjeter që do të konsiderohet i nevojshëm ose i dobishëm për këtë qëllim, të marrë hua ose të aksesuara çdo lloj krediti dhe/ose operacioni finansiar, të jape dorëzani, të lëshojë garanci të pavarura me kërkesë të parë dhe të jep garanci reale, personale, peng dhe privilegje të veçanta, edhe pa pagesë si në interesin e vet ashtu edhe në favor të palëve të treta, përfshirë, por pa u kufizuar, jo anëtarët dhe shoqëritë e drejtpërdrejta ose të tërthorta.

Në çdo rast, përjashtohet grumbullimi i kursimeve në çdo formë dhe, gjithashtu, çdo aktivitet ndërmjetësimi i rezervuar për shoqëritë e ndërmjetësimit të letrave me vlerë, në përputhje me ligjet në fuqi. Aktiviteti finansiar nuk mund të ushtrohet ndaj publikut.

### Neni 5

#### Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj tregtar për një periudhë prej më shumë se 30 vitesh, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### KREU II

#### KAPITALI

### Neni 6

#### Kapitali i shoqërisë

Kapitali shoqëror i shoqërisë është 1.000.000,00 (një milion/00) lekë shqiptare, i përbërë nga një kuotë e vetme që i përket ortakut të vetëm si më poshtë: "**Vivenda S.p.A.**" me 100% të kuotave = 1.000.000,00 lekë.

Të gjitha kuotat e kapitalit fillestar janë nënskruar dhe janë paguar plotësisht.

Kapitali fillestar përbëhet nga një kuotë me vlerë prej 1.000.000,00 lekë shqiptare. Kjo kuotë i përket ortakut të vetëm "Medihospes Cooperativa Sociale".

Qdo ortak ka të drejtë vote në asamble në masë proporcionale me pjesëmarrjen e tij.

Pjesët e kapitalit shoqëror nuk mund të përfaqësohen nga tituj me vlerë te tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme ose të paluajtshme, të drejta). Një ortak që është i penguar të ushtrojë të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë ka të drejtë t'i kerkojë gjykates të urdhërojë heqjen e shkeljes ose shpërblimin e dëmeve të shkaktuara si pasojë e shkeljes së këtyre të drejtave. Kjo e drejtë duhet të ushtrohet brenda 3 vjetëve nga data e shkeljes.

### Neni 7

#### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve te pjesëve te kapitalit themeltar për kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nëpërmjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar për keto kontribute sipas kërkesës se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogëlimi prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Vendimi për ndryshimin e kapitalit i njoftohet Qendrës

Kombëtare te Prezistencës së ministrave të administratës



*W*

ne përputhje me nenin 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit".

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te një shoqërie me përgjegjësi te kufizuar e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nëpermjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërise;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjeter te parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet të behet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërise, me miratimin e shoqërise dhe të drejtën e parablerjes ne favor te shoqërise apo te ortakeve te tjere, sipas modaliteteve dhe shumicës se cilësuar që kërkon ndryshimi i statutit.

Personi qe kalon kuotën dhe ai qe e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri ne çastin e regjistrimit te kalimit te saj ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit, sipas nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakeve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organet vendimmarrëse dhe drejtuese

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare te shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkallëzimit - administrativ.

W

c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabël te autorizuar;

d) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" te kësaj pike;

dh) Mbikëqyrjen e zbatimit to politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë se veprimtarisë;

e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore, dhe te raporteve te ecurisë se veprimtarisë;

ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

g) përfaqësimin e shoqërisë ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorëve;

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve to asamblesë;

i) çështje të tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

j) Të gjithë veprimet qe kane te bëjnë me shitjet - blerjet lidhjet e kontratave me të tretët te çdo lloji, me organet qëndrore etj do të kryhen vetëm nga personi apo personat e autorizuar me vendim të asamblesë se ortakeve.

k) Kontratat e punës se punonjësve, paga e shpërblimi i tyre do te bëhen nga personi apo persona te autorizuar me vendim të asamblesë se ortakeve.

l) Ndarja e fitimit dhe shpërblimi midis ortakeve do të bëhet me vendim të asamblesë se ortakeve

m) Me vendim te asamblesë se ortakeve caktohen personi apo personat qe do te përfaqësojnë shoqerinë përpara bankave te çdo niveli qe operojnë ne Republikën e Shqipërisë, ne këtë vendim do te përcaktohet ne mënyrë te detajuar kompetencat e personit apo personave qe do te veprojnë ne emër te shoqërisë me bankat. Edhe administratori i shoqërisë do te hape i llogari apo kryeje veprime me bankat vetem me autorizim te asamblesë se ortakeve te shoqërisë

Ortaku mund te përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjeter apo nga një person i trete.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veproje si përfaqësues i ortakeve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje te asamblesë se përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

përmes komunikimit me postë elektronike. Njoftimi i shkruar ose mesazhi elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe duhet t'u dërgohet të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 ditë para datës së parashikuar për mbledhjen. Në rast se asambleja e përgjithshme nuk thirret sipas parashikimeve të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime detyruese vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord të marrin vendime, pavarësisht nga parregullsia.

Neni 11

Kuorumi

- Në rastin e vendimeve që kërkojnë një shumicë të thjeshtë, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zoterojnë më shumë se 30% të kuotave.
- Në rast se Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë mbi çështje që kërkojnë një shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Pëtregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm personalisht ose votojne me shkrim ose përmes mjeteve elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji, ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të permendor më lart, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite.

Neni 12

Marrja e vendimeve

Asambleja e Përgjithshme, për të ndryshuar statutin, për të rritur ose ulur kapitalin social, për të shpérndarë fitimet, për të miratuar bilancin, për të kontrolluar llogaritë, për të miratuar rregullat procedurale të mbledhjeve të Asamblesë, për të riorganizuar, bashkuar ose ndarë shqërinë, për ta shnderruar atë ne një formë tjetër, për të transferuar kuotat, për të emëruar ekspertë dhe likuidatorë dhe për të shpërbërë shqërinë, mban mbledhje të jashtëzakonshme, të cilat janë të vlefshme kur janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zoterojnë më shumë se gjysmën e kuotave të kapitalit social të shqërise dhe votojnë me shkrim ose përmes mjeteve elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit 9901 të datës 14.04.2008 dhe vendimet janë të vlefshme me voten e favorshme të 3/4 të ortakëve pjesëmarrës. Asambleja e Përgjithshme merr vendime me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, kur janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zoterojnë më shumë se 30% të kuotave, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shqërisë;
- b) emërimi dhe shkarkimi i administratorëve dhe atribuimi i kompetencave për administratorët;
- c) emërimi dhe shkarkimi i likuidatorëve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimi i pagave;
- e) mbikëqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, perfshire përgatitjen e bilanceve vjetore dhe raporteve mbi securinë e veprimtarisë;
- f) përfaqësimi i shqërisë në gjykatë dhe ne procedura të tjera kundër administratorëve.

Çdo ndryshim i statutit duhet të depozitohet në QKR (Qendra Kombëtare e Regjistrimit) për qëllime të publikimit të ndryshimeve në regjistrin e shqërisë.

#### Neni 13

##### Administrimi

Shqëria do të administrohet nga një administrator.

Administratori i Shqërisë është Marco Gualandri, i lindur në Romë (RM) më 19/03/1966, banues në Romë në rrugën Via dei Barbisio nr. 29, C.P. GLNMRC66C19H501G, i identifikuar me pasaportën e tij N.YB3126271, i cili do të ushtrojë funksionet e administrimit sipas statutit dhe ligjit për një periudhë prej 5 vjetësh me të drejtë rinovimi.

#### Neni 14

##### Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtën dhe detyrimin të:

- a) kryejë të gjitha operacionet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të përcaktuara nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shqërinë tregtare;
- c) sigurohet për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të shqërisë;
- d) nënshkruejë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin mbi securinë e veprimtarisë dhe, se bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të paragesë keto dokumente në asamblenë e përgjithshme për miratim;
- e) krijoje një sistem paralajmërimi të perkohshëm për rrethanat që kërcënojnë securinë e mirë të veprimtarisë dhe ekzistencën e shqërisë;
- f) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shqërisë, sic parashikohet nga liri i mësuar.

Kombëtare të Regjistrimit;

- g) raportojë në asamblenë e përgjithshme mbi zbatimin e politikave tregtare dhe mbi realizimin e operacioneve veçanërisht të rëndësishme për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) përfaqësojë shoqërinë përpara organeve të drejtësisë, gjykatave dhe prokurorive, organeve të administratës shtetërore qendrore ose lokale, zyrtarët tatimeve;
- i) kryejë të gjitha operacionet e administrimit të zakonshëm të shoqërisë.

Neni 15

**Përgjegjësitë e Administratorit**

Administratori është individualisht përgjegjës ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkeljet e ligjeve, statutit ose faj të rënë të kryer gjatë menaxhimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të paaprovuara nga asambleja që shkaktojnë dëme në shoqëri i atribuohen administratorit dhe ortakut që ka përfunduar marrëveshjen, të cilët do të mbajnë pasojat përkatëse individualisht ose së bashku, në varësi të rastit.

Përveç sa parashikohet nga dispozitat e përgjithshme mbi detyrimin e besnikërisë, në bazë të neneve 14, 15, 17 dhe 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori është i detyruar:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara nga ligji dhe statuti me besim të mirë dhe në interesin më të mirë të shoqërisë në terësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të aktivitetit të shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat e përcaktuara nga ligji dhe statuti vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret një vendim;
- d) të parandalojë dhe eliminojë rastet e konfliktit, të pranishëm ose potencial, ndërmjet interesave personale dhe atyre të shoqërisë;
- e) të kryejë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, është përgjegjës ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim të lidhur në mënyrë të arsyeshme me objektivat tregtare të shoqërisë, përveç rasteve kur, bazuar në hetimin dhe vlerësimin e informacionit përkates, veprimi ose mosvenrimi poftës kryer me besim të mirë.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, është i detyruar të dëmshpérblejë shoqerinë për dëmet që rrjedhin nga shkelja, si dhe të transferojë te shoqeria çdo përfitim personal që ai ose personat e lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e pravës për të treguar se ka kryer detyrat e tij në mënyrë të mrekullt dhe sipas standardeve të kërkua.



Në veçanti, por pa u kufizuar vetëm në to, administratori është i detyruar të dëmshpérblejë shoqerinë për dëmet e shkaktuara nëse, në shkelje të dispozitave të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) kthimin e kontributave ortakëve;
- b) pagimin e interesave ose dividendëve ortakëve;
- c) shpërndarjen e aktiveve të shoqërisë;
- d) lejimin që shoqeria të vazhdojë aktivitetin tregtar, kur, bazuar në situatën financiare, duhet të parashikohet që shoqeria nuk do të ketë aftësinë për të paguar borxhet;
- e) dhënien e financimeve.

Përveç padisë për dëmshpérblim të ngarkuar personalisht ndaj administratorit, ortakët, individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të parqesin një veprim penal kundër administratorit. Paditesit kanë të drejtë të ndjekin ligjërisht dëmshpérblimin e plotë te dëmit të shkaktuar shoqërise, përfshirë dëmshpérblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të pengojë paraqitjen e një kërkesë për dëmshpérblim kundër administratorit për gabimet e kryera gjatë ushtrimit të detyrës së tij.

#### Neni 16

##### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 janar dhe perfundon më 31 dhjetor. Në mënyrë të jashtëzakonshme, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbylljet më 31 dhjetor.

#### Neni 17

##### Bilanci i shoqërisë dhe dividentet

Brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar, Asambleja e

Asambleja e Aksionarëve vendos për shpërndarjen e dividendëve, pas zbritjes së humbjeve të vitit finanziar të mëparshëm, ashtu siç parashikohet nga ligji.

Neni 18

**Ekspertet**

Eksperti ka detyrën të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqatës, si ai vjetor dhe ai i kontrollit periodik të bëne në rastet kur është caktuar dhe ka kryer këtë veprimtari sipas mënyrit të ortakëve. Pas përfundimit të kontrollit, eksperti kontabel i autorizuar pergatit një raport shkrimi me rezultatet e bilancit finanziar vjetor, si dhe rezultatet e kontrollit periodik të kryer, që është i detyruar ta paraqesë dhe ta dorezoje në kohë të afërt ortakëve, për t'u shqyrtuar dhe miratuar sipas të drejtës vendimmarrëse që ata kanë.

Neni 19

Të ardhurat neto që mbeten pas ndarjes së fondeve ligjore dhe pagesave për të tretët, si dhe pas pagesës së çdo detyrimi tatimor, mbetur pronë e bashkëpronarëve.

Neni 20

**Shpërndarja ose prishja e shoqërisë**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund te bëhet në çdo kohë:

- kur përfundon afati i paraparë në statut;
- me vendim të Asamblesë së Pjesëmarrësve;
- me hapjen e procedurave falimentare;
- nëse nuk ka ushtruar aktivitet tregtar për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i aktivitetit në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- me vendim të gjykates.

Në këtë rast, ortakët marrin një vendim shkruar në të cilin përcaktojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një ose më shumë likuidatorë dhe duke shënuar në çdo dokument të lëshuar emrin e likuidatorit dhe shtesën "Shoqeri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërisë tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditave pas prishjes, ndërsa

drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### Neni 21

##### Likuiduesi

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e caktimit të tij. Nëse shoqëria emëron me shume se një likuidues, pervecse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njeri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht to drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund te autorizojnë njërin prej tyre të kryejet vepprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejt~~shken~~ të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtronhet mbikëqyrjes se ortakut dhe administratorit.

#### Neni 22

##### Baza Ligjore

Shoqëria do të krejë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 23

##### Mosmarrëveshjet


Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

#### Neni 24

##### Dispozita përfundimtare

Ky statut u redaktua ne 4 ekzemplare me përbajtje dhe vlera te njëjta juridike, ne gjuhen shqipe, u miratua, ne parim nen për nen nga Ortaket e shoqërisë tregtare "Vivenda Albania" Sh.p.k., nënshkruehet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale.

Ortaku i vetem  
Vivenda S.p.A.  
administratori  
Marco Gualandri



STATUTO  
DELLA SOCIETÀ A RESPONSABILITÀ LIMITATA  
"VIVENDA ALBANIA" S.r.l.

CAPITOLO I

**COSTITUZIONE, FORMA, DENOMINAZIONE, OGGETTO, SEDE E DURATA DELLA SOCIETÀ.**

La società a responsabilità limitata "VIVENDA ALBANIA" S.r.l., con sede legale in Tirana, all'indirizzo: Kulla Condor Center R- Kati i 5-të, Ap. 14, Rruga e Kavajës, è stata costituita in conformità al contratto allegato a questo statuto redatto e sottoscritto da:

Società di diritto italiano "Vivenda S.p.A.", con sede legale in Roma (RM) Via F. Antolisei n.25, Codice Fiscale e Partita IVA n. 01709130767, iscritta all'Albo delle Soc. Coop. a mutualità prevalente con n° A193548 in data 04/07/2008, rappresentata dal sig. Marco Gualandri, cittadino italiano, nato a Roma(RM) il 19/03/1966, identificato dal suo Passaporto N.YB3126271 in qualità di Presidente del Consiglio di Amministrazione e Legale Rappresentante della società, (da qui in seguito "Vivenda"), la quale si è convenuta per la costituzione della società "**Vivenda Albania**" s.r.l.

Che ha redatto questo statuto della società "**Vivenda Albania**" s.r.l., in conformità alla legge n. 9901 del 14.04.2008, "Per i commercianti e le società commerciali", la legge n. 9723 del 03.05.2007 "Per il Registro Nazionale", il Codice Doganale, Fiscale e Tributario, come segue:

Articolo 1

Costituzione

La società acquisisce personalità giuridica dal giorno della sua registrazione.

La denominazione della società è "**Vivenda Albania**" s.r.l.

